

NDIKIMI I PRANISË NDËRKOMBËTARE NË ZHVILLIMIN E DREJTËSISË PENALE NË KOSOVËN E PASLUFTËS: SFIDAT E BASHKËPUNIMIT (TË MUNGUAR) MES GJYQTARËVE VENDORË DHE NDËRKOMBËTARË

* Gentian GURRA¹

Abstrakt:

Duke vlerësuar nevojën për funksionimin efikas dhe të paanshëm të drejtësisë penale në kontekstin historik të Kosovës së vitit 2000, nëpërmjet Rregullores së UNMIK-ut 2000/6, PSSP vendosi kooptimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë. Rregullorja parashikonte emërimin e këtyre gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë prej PSSP-së dhe “integrimin” e tyre në sistemin ekzistues gjyqësor. Rregullorja parashikonte që prokurorët ndërkombëtarë mund të zgjidhnin një rast të caktuar, zakonisht krime që cilësohen në çdo juridiksion si “të rënda”, bazuar në konsiderata ndaj karakterit ndër-etnik të krimit (i akuzuari i përket një etnie të ndryshme nga viktima), krime luftime apo krime të tjera të një karakteri të rëndë, ndjekja penale e të cilave nuk mund të ushtrohet prej prokurorëve vendorë për shkaqe që variojnë prej dyshimit të bazuar për mungesë paanshmërie deri në pamundësi objektive për shkaqe sigurie. Artikulli do të ndjekë një rrjedhë kronologjike të ngjarjeve relevante për të kulmuar me argumente që vënë në pikëpyetje dobishmërinë e sistemit ekzistues të drejtësisë penale “mikse” në dritën e zhvillimeve të pritshme politike në Kosovë.

Fjalët kyç: *Gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë, sistem penal miks, rritje e kapaciteteve vendore, bashkëpunim.*

1. Konteksti Historik dhe Rivënia në Funksionim e Institucioneve Gjyqësore

Tërheqja e forcave policore e ushtarake nga Kosova pas marrëveshjes së Kumanovës la pas një Kosovë të lirë, qytetarë të çliruar jo vetëm prej zgjedhës policore-ushtarake por

* Gentian Gurra, Nëpunës juridik, IJSD/DoJ-UNMIK, 10 Gusht 2007. Opinione e shprehura në këtë artikull janë vetëm të autorit dhe nuk shprehin qëndrimin të organizatës për të cilën ai punon.

dhe prej institucioneve të një karakteri të theksuar represiv. Që prej bojkotimit masiv të këtyre institucioneve prej popullsisë shqiptare dhe ngritjes së sistemit paralel, në syrin e qytetarit shqiptar të Kosovës, gjykata nuk përbënte më një institucion të besueshëm.

Gjykatat por dhe zyrat e Prokurorisë Publike të pasluftës, ashtu si gjithë institucionet e tjera në Kosovë, ishin jofunksionale, madje të boshatisura dhe pa personel për të ushtruar normalisht funksionin e tyre. Pjesa më e madhe e gjyqtarëve dhe prokurorëve që kishin shërbyer në këto institucione para lufte tashmë e kishin lënë Kosovën dhe rivendosja në funksionim e këtyre institucioneve parashtrohej si detyrë imediate e PSSP të OKB-së.

Ndër hapat e parë për mbushjen e këtij vakuumi institucional ishin Rregulloret e UNMIK-ut 1999/5², 1999/6³ dhe 1999/7⁴, nëpërmjet të cilave Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, në përputhje me autoritetin që i jep Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, krijoi bazat e strukturimit të gjyqësorit kosovar të pasluftës. Hapat e parë ishin krijimi i Gjykatës ad-hoc për Shqyrtimin e Ankesës Përfundimtare dhe Zyrën e Prokurorit Publik ad-hoc. Këto dy institucione që do të kryenin funksionet e Gjykatës Supreme dhe Prokurorisë Publike, megjithëse në terma ad-hoc, ishin themelet e pallatit të drejtësisë së pasluftës. Hapi i parë u pasua prej krijimit të Komisionit Këshillëdhënës Teknik për Çështje Gjyqësore dhe të Prokurorisë dhe më tej me krijimin e Komisionit Këshillëdhënës Gjyqësor.

Këto dy komisione të konstituara nëpërmjet rregulloreve të UNMIK-ut 1999/6 dhe 1999/7 ishin instrumente që i ndihmuan PSSP-së në proceset e: 1) themelimit të strukturës dhe administratës së gjyqësorit dhe prokurorisë publike 2) rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe shqyrtimit të ankesave lidhur me punën e tyre. Këto dy instrumente u konceptuan me një përbërje mikse ekspertësh vendorë dhe ndërkombëtarë dhe pikërisht këtyre dy strukturave pioniere u takon merita e ndërtimit nga e para të sistemit gjyqësor në Kosovë. Një rëndësi të veçantë ka roli që luajtën këto dy komisioneve në rikonceptimin dhe ringritjen e institucioneve gjyqësore dhe veçanërisht

² Rregullorja e UNMIK-ut 1999/5 “Për krijimin e Gjykatës *ad hoc* të instancës së fundit dhe prokurorisë *ad hoc*”, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut.

³ Rregullorja e UNMIK –ut 1999/6 “Për rekomandimet mbi strukturën dhe administratën e shërbimit gjyqësor dhe të prokurorisë”, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut.

⁴ Rregullorja e UNMIK-ut 1999/7 “Për Emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut.

në prezantimin për të parën herë të nevojës për inkorporimin e profesionistëve ndërkombëtarë në gjyqësorin latent të Kosovës të asaj kohe.

Komisioni Këshillëdhënës Teknik për Çështje Gjyqësore propozoi dhe më tej konceptoi dhe i dha formë një projekti mjaft ambicioz për krijimin e një gjykate me përbërje mikse në Kosovë për gjykimin kryesisht të krimeve të luftës dhe krimeve të tjera ndëretnike. Në projekt kjo gjykatë u quajt Gjykata për Krimet e Luftës dhe ato Etnike dhe modeli për krijimin e saj ishte huazuar prej Tribunalit Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi me qendër në Hagë⁵. Gjykata do të drejtohej prej një gjyqtari ndërkombëtar dhe do të gjykonte në kolegje të përbëra prej gjyqtarësh vendorë dhe ndërkombëtarë. Juridiksionin gjykata e ndante me Tribunalin Penal për Krimet në ish-Jugosllavi në kuptimin që objekt i punës së saj ishin krimet e luftës, gjenocidi, krimet kundër njerëzimit dhe krime të tjera të rënda me sfond ndër-etnik, të cilat nuk mund te gjykoheshin prej Tribunali të Hagës. Tribunali, megjithë zgjatjen deri në 2008 të mandatit të tij e kishte dhe e ka plotësisht të pamundur marrjen në shqyrtim të të gjitha rasteve të hetuara apo në proces hetimi, për krime që përbëjnë objekt të shqyrtimit të tij, të kryera në Kosovë prej 1 Janarit 1998. Për arsye që për perceptimin publik paraqiten si logjistike, por që në fakt rezultojnë me sfond të pastër politik, gjykata nuk arriti të dalë në dritë dhe projekti dështoi zyrtarisht në shtator 2000⁶ megjithëse nuk i mungoi përkrahja, jo vetëm ndërkombëtare. Në komunitetin juridik vendas projekti duhet thënë se gjeti mbështetje të admirueshme.

Por roli i dy komisioneve me kompetenca këshillëdhënëse nuk mund të thuhet se sfumohet me dështimin e projektit të Gjykatës për Krimet e Luftës dhe ato Etnike. Dy komisionet, pavarësisht problemeve, arritën në kohë rekord të venë në funksionim gjykatat dhe prokuroritë në mbarë Kosovën. Është me vend të kujtojmë këtu se formimi akademik i juristëve shqiptarë të Kosovës pothuajse ishte ndërprerë prej më se 10 vjetësh dhe shkollimi i kryer në sistemin paralel të shkollimit të ngritur dhe zhvilluar nën regjimin e Milosheviçit paraqitej nën një standard jo-optimal⁷. Një rol të rëndësishëm në

⁵ T. Perriello and M. Wierda, *Lessons from the Deployment of International Judges and Prosecutors in Kosovo*, International Center for Transitional Justice, March 2006, fq. 11 (shih online: <http://www.ictj.org/static/Prosecutions/Kosovo.study.pdf>).

⁶ Po aty.

⁷ Judicial Reform Index for Kosovo – ABA/CEELI, prill 2002, fq. 8 (online në: <http://www.abanet.org/rol/publications/kosovo-jri-2002-eng.pdf>).

këtë kontekst duhet thënë se luajti dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë nëpërmjet asistencës teknike që i ofroi këtyre dy strukturave në hapat e parë të eliminimit të këtij vakuumi institucional në gjyqësinë e Kosovës.

Në punën e tij për përzgjedhjen e kandidatëve për postet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, Komisioni Këshillëdhënës Gjyqësor, u udhëhoq prej kritereve objektive të parashtruara qartë në rregulloren 1999/7 ndërmjet të cilave veç atyre profesionale spikasnin: mospërfshirja në shqiptimin e masave diskriminuese, aplikimin e ligjeve diskriminuese apo implementimin e politikave diktatoriale të zbatuara në Kosovë gjatë represionit të pushtetit Serb. Gjyqtarët dhe prokurorët u zgjodhën nga radhët e juristëve me përvojë të njohur në opinionin publik për profesionalizëm. Ata ishin kryesisht ish-gjyqtarë dhe ish-prokurorë por nuk munguan dhe të përzgjedhurit nga radhët e avokatëve por dhe të ish-funksionarëve të tjerë të paraluftës. Megjithë hatërmbetjet dhe pakënaqësitë që solli ky proces, kryesisht të një karakteri politik, duhet thënë se në procesin e rekrutimit të profesionistëve në gjyqësor përgjithësisht mbizotëruan kritere si integriteti profesional dhe figura morale.

Nga ana tjetër, Rezoluta 1244 e KS të OKB-së, e vendoste Kosovën nën një administrim ndërkombëtar të drejtuar prej Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP). Duke vlerësuar nevojën për funksionimin efikas dhe të paanshëm të drejtësisë penale në kontekstin historik të Kosovës së vitit 2000, nëpërmjet Rregullores së UNMIK-ut 2000/6, PSSP vendosi për të parën herë kooptimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë.

2. Hapi i Parë në Krijimin e Gjykatave me Përbërje Mikse

Rregullorja parashikonte emërimin e këtyre gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë prej PSSP-së dhe “integrimin” e tyre në sistemin ekzistues gjyqësor penal. Si pikënisje dhe njëkohësisht provë e efikasitetit të këtij “projekti integruar” të magistratëve ndërkombëtarë në sistemin gjyqësor Kosovar të sapongritur në këmbë, shërbeu Gjykata e Qarkut në Mitrovicë⁸. Diversiteti etnik i spikatur, që rëndom pasqyrohej si faktor determinant në volumnin e punës së drejtësisë penale në këtë qark, në një farë mënyre

⁸ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/6 “Për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të prokurorëve ndërkombëtarë dhe gjyqtarëve ndërkombëtarë”, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut.

justifikonte qëllimin kryesor të kësaj ndërmarrjeje: eliminimin e çdo forme diskriminimi në dhënien e drejtësisë penale.

Natyrisht që përvoja e diskriminimit ndaj komunitetit shqiptar, e aplikuar për një periudhë relativisht të gjatë kohore, kombinuar me kufizimet e arsyeshme të sistemit gjyqësor kosovar në këtë moment të fillimit të funksionimit, përbënin arsye të mjaftueshme në formimin e perceptimit të përgjithshëm që gjykimi i paanshëm i krimeve të kryera prej anëtarëve të komunitetit serb prej gjykatësve shqiptarë, të sapoemëruar, ishte pothuajse i pamundur. Duhet thënë se në realitet nuk munguan rastet që provonin se një perceptim i tillë nuk ishte i pavërtetë⁹. Rregullorja parashikonte që prokurorët dhe gjyqtarët ndërkombëtarë, të emëruar prej PSSP, mund të zgjidhnin të ushtronin ndjekjen penale apo gjykonin një rast të caktuar pa parashikuar kritere strikte apo kufizime lidhur me llojet e veprave për të cilat mund të zbatohet ky diskrecion. “Eksperimenti” i integritetit të ndërkombëtarëve në sistem, i provuar si rezultativ në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës, u shtri në gjykatat e tjera të qarkut në mbarë Kosovën (Prishtinë, Prizren, Gjiilan, Pejë) dhe madje edhe në Gjykatën Supreme nëpërmjet Rregullores së UNMIK-ut 2000/34 të Majit 2000.¹⁰

Asnjë prej rregulloreve të cituara më sipër nuk parashikonte kufij të shtrirjes së kompetencës së magjistratëve ndërkombëtarë. Praktikisht gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë autorizoheshin të ushtronin funksionet e detyrës së tyre, duke përfshirë këtu edhe autorizimin për marrjen në shqyrtim të rasteve të reja penale, të pashqyrtuara, brenda juridiksionit të gjykatës në të cilën ata ushtronin detyrën¹¹. Kategoria e krimeve për ndjekjen penale apo gjykimin e të cilave angazhoheshin gjyqtarët ndërkombëtarë me kohë u kufizua, në praktikë, përtej krimeve të luftës, në krime që në çdo juridiksion cilësohen si “të rënda”, bazuar në konsiderata ndaj karakterit ndër-etnik të krimit (i akuzuari i përket një etnie të ndryshme nga viktima), apo krime të tjera të një karakteri të rëndë. Ndjekja penale e këtyre kategorive të krimeve u gjykua praktikisht e pamundur të kryhej prej prokurorëve vendorë apo shqyrtimi i tyre gjyqësor nuk mund të ndërmerrej

⁹ “Lessons from the Deployment of International Judges and Prosecutors in Kosovo” prej International Center for Transitional Justice, March 2006, fq. 12-13.

¹⁰ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/34 “Mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/6 Për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të prokurorëve ndërkombëtarë dhe gjyqtarëve ndërkombëtarë”, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut.

¹¹ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/6 “Për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të prokurorëve ndërkombëtarë dhe gjyqtarëve ndërkombëtarë”, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut.

prej gjyqtarëve vendorë për shkaqe që varionin prej dyshimit të bazuar për mungesë paanshmërie deri në pamundësi objektive për shkaqe sigurie.

Por megjithë praninë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ndërkombëtarë tanimë në çdo gjykatë qarku të Kosovës dhe përfshirjen aktive të tyre në kolegjet penale për gjykimin e krimeve të motivuara etnikisht, mekanizmat e parashikuar në Rregulloret e UNMIK-ut 2000/6 dhe 2000/34 nuk rezultuan të mjaftueshme për eliminimin e anshmërisë në dhënien e drejtësisë penale. Kjo u theksua në një numër raportesh përpiluar si nga komuniteti i OJQ-ve aktive në fushën e drejtësisë, ashtu dhe nga OSBE-ja¹². Këto raporte theksonin që gjyqtarët ndërkombëtarë shpesh mbeteshin në minorancë prej kolegëve vendorë në vendimet e kolegjeve penale dhe sugjeronin rishikimin e skemës së funksionimit të kolegjeve mikse në mënyrë që prania ndërkombëtare në gjyqësor të bëhej funksionale¹³. Dhe këto sugjerime nuk ranë në vesh të shurdhër. Jo më larg se dhjetori i vitit 2000 PSSP-ja shpalli një rregullim të ri të përbërjes së kolegjeve penale “mikse”. Rregullorja 2000/64¹⁴ përbënte një hap vërtet kulminant dhe me pasoja të rëndësishme në drejtësinë penale të pasluftës në kuptim të përfshirjes dhe rolit të gjyqtarëve ndërkombëtarë.

3. Rregulloja 2000/64 si Pikë Kthese në Integrimin e Gjyqtarëve Ndërkombëtarë në Sistemin Gjyqësor të Kosovës.

Duke theksuar qëllimin e sigurimit të pavarësisë dhe paanësisë së gjyqësorit, PSSP-ja nëpërmjet kësaj rregulloreje nga njëra anë synonte të minimizonte çdo mundësi të perceptuar ndikimi në gjyqësor nëpërmjet minimizimit të rolit të gjyqtarëve vendorë në gjykimin e çështjeve penale me implikime ndëretnike dhe nga ana tjetër vishte me përgjegjësi të plotë përfaqësimin ndërkombëtar në gjyqësor për administrimin e drejtësisë penale dhe sigurimin e kësaj pavarësie dhe paanshmërie. Mekanizmi i përdorur – kolegje penale me shumicë gjyqtarësh ndërkombëtarë në përbërje¹⁵ – çonte domosdoshmërisht drejt një administrimi të pavarur ndërkombëtar të drejtësisë penale në krimet me

¹² “Lessons from the Deployment of International Judges and Prosecutors in Kosovo” prej International Center for Transitional Justice, March 2006, fq. 12-13.

¹³ Po aty.

¹⁴ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 “Për caktimin e gjyqtarëve /prokurorëve ndërkombëtarë dhe/ose ndryshimin e vendit të zhvillimit të gjykimit.”

¹⁵ Section 2.1 (c), po aty.

implikime ndëretnike. Në këtë kuptim, ky akt legjislativ përbënte hapin më revolucionar të reformës në drejtësinë penale të administratës ndërkombëtare të instaluar në Kosovën e pasluftës. Nga pikëpamja funksionale, Rregullorja autorizonte PSSP-në të caktonte në autoritetin e tij një gjyqtar ndërkombëtar apo një kolegji prej vetëm 3 gjyqtarësh, me shumicë gjyqtarësh ndërkombëtarë në përbërje, bazuar në një kërkesë të motivuar të Departamentit të Drejtësisë. Ky i fundit nga ana tjetër vihej në veprim nëpërmjet një kërkesë për aplikimin e Rreg. 2000/64 prej prokurorit, të akuzuarit apo avokatit të tij mbrojtës. Caktimi i gjyqtarit apo kolegjit, sipas rregullores, bëhej në çdo gjykatë brenda territorit të Kosovës dhe në çdo fazë të procedurës penale, mjafton që të mos kish filluar shqyrtimi gjyqësor i lëndës apo shqyrtimi i apelit nga gjykata e shkallës së dytë. Zbatimi i rregullores solli rritje të ndjeshme të numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, të cilët operonin në sistem duke zbatuar të njëjtën kornizë ligjore, brenda të njëjtave organizma gjyqësore, por që në të vërtetë filluan të funksionojnë si sistem paralel organizimi gjyqësor. Në ndryshim prej kolegjeve vendorë, të cilëve rastet për gjykim u ndaheshin prej kryetarit respektiv të gjykatës, caktimi i rasteve për gjyqtarët ndërkombëtarë kryhej vetëm prej drejtorit të Departamentit të Drejtësisë.

Në pikëpamje të pavarësisë dhe paanshmërisë së kërkuar, sistemi fitoi vërtet shumë me mbulimin prej kolegjeve penale ndërkombëtare të lëndëve më sensitive, pasi nuk mund të konceptohej ndërhyrja nga jashtë në pavarësinë e një gjyqtari ndërkombëtar. Edhe në pikëpamje të sigurisë personale, gjyqtarët ndërkombëtarë kishin të gjithë mbështetjen e duhur prej UNMIK-ut. Në raste të veçanta ku siguria personale do të vihej në pikëpyetje për motive të ndryshme lidhur me rrezikshmërinë individuale të të pandehurve, apo ndjeshmërinë e lëndës në gjykim, magjistratëve ndërkombëtarë u ofrohej eskortë personale. Por ajo çka u kritikua fort dhe që ende përbën një problem të rrahur mjaft prej vëshguesve dhe kritikëve të pavarur të performancës gjyqësore të ndërkombëtarëve në Kosovë, është fakti i mungesës së një ndarjeje të qartë dhe në përputhje me standardet dhe përvojat më të mira perëndimore ndërmjet gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë. Si ndjekja penale, ashtu edhe shqyrtimi gjyqësor, në organizimin e stafit ndërkombëtar që kryente këto funksione ishin vendosur, si janë dhe sot, brenda të njëjtës çadër, të menaxhuar prej të njëjtit institucion: Departamentit të Drejtësisë. Ky fakt nuk shihej me sy të mirë prej komunitetit juridik vendas dhe me kohë

ndikoi si element negativ në perceptimin e përgjithshëm mbi drejtësinë penale të administruar prej magistratëve ndërkombëtarë.

Rregullorja 2000/64, ashtu si dhe aktet e tjera të mëparshme që rregullonin veprimtarinë e magistratëve ndërkombëtarë në sistemin gjyqësor Kosovar, nuk përcaktonte në mënyrë të qartë diapazonin e lëndëve penale ku mund të ndërhyjnë prokurorët apo gjyqtarët ndërkombëtarë. Teorikisht ndërhyrja ndërkombëtare mund të shtrihej në çdo lëndë penale por në praktikë numri i kufizuar i gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë impononte një shtrirje të kufizuar të kategorive të çështjeve ku ata mund të përfshiheshin. Përveç krimeve të luftës apo krimeve të tjera me implikime ndëretnike, me kohë dhe në përgjigje të prioritetëve të luftës ndaj kriminalitetit, prokurorët dhe gjyqtarët ndërkombëtarë e shtrinë aktivitetin e tyre dhe në lëndë me objekt korrupsionin dhe krimin e organizuar. Megjithatë numri i rasteve të shqyrtuara prej tyre në numrin e përgjithshëm të lëndëve penale në sistemin gjyqësor Kosovar në vitin 2003 nuk i kalonte 5%¹⁶. Kjo e dhënë statistikore vazhdon edhe sot të mbetet në të njëjtat nivele.

4. Ndërtimi i Kapaciteteve në Gjyqësor – Sfidë apo Prioritet i Harruar

Një prej arsyeve që justifikuan kooptimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë në sistemin gjyqësor të Kosovës, përveç dyshimeve të justifikuara mbi pavarësinë dhe paanshmërinë e profesionistëve vendorë në fillim ishte dhe mungesa, në perceptimin e përgjithshëm profesional, e kapacitetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rekrutuar rishtazi në sistem për të administruar drejtësinë në këtë fazë të brishtë post-konfliktuale. Por nëpërmjet Rregullores 2000/64 UNMIK-u shpallte hapur se qëllimi i sigurimit të pranisë ndërkombëtare në gjyqësor ishte gjykimi i rasteve objekt i punës së ndërkombëtarëve, duke mos konsideruar më në rend të ditës ndërtimin e kapaciteteve në gjyqësorin kosovar. Ndërveprimi ndërmjet gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe kolegëve të tyre vendorë pothuajse u ndërpre. Edhe në rastet ku jo të tre anëtarët e kolegjit të formuar sipas Rregullores 2000/64 ishin ndërkombëtarë, barriera si mungesa e komunikimit për shkak të gjuhës e bënin këtë ndërveprim pothuajse të pamundur dhe në mjaft raste roli i gjyqtarit

¹⁶ “Preparing for transfer of justice sector policy making in Kosovo” – Atos KPMG Consulting November 2003, fq. 96.

vendor në këto kolegje mikse, të paktën në perceptimin e përgjithshëm, ishte thjesht formal. Por duhet theksuar gjithashtu se bashkëveprimi ndërmjet kolegëve vendorë dhe ndërkombëtarë tanimë nuk konsiderohej i dobishëm as prej vendorëve. Në opinionin e përgjithshëm të magjistratëve kosovarë gjyqtarët ndërkombëtarë nuk shikoheshin më si “shpëtimtarët” e sistemit gjyqësor dhe aq më pak besohej se ata do të kontribuonin në “ringritjen” dhe modernizimin e gjyqësisë kosovare në përputhje me standardet perëndimore të synuara. Gjyqtarët ndërkombëtarë, rëndom shiheshin si juristë të cilëve u mungonte njohja e sistemit ligjor këtu dhe eksperiencia në këtë sistem. Duhet thënë se gjyqtarët ndërkombëtarë të rekrutuar prej UNMIK-ut në vitet 2000-2001 vinin kryesisht prej Afrikës, Azisë dhe Europës Juglindore, ndërsa ishte e vështirë për Amerikano-veriorët apo Europiano-perëndimorët të shkëputeshin prej gjykatave në vendet e tyre për të shërbyer, për një periudhë 6-mujore në Kosovë¹⁷. Ky element perceptohej gjerësisht në komunitetin e magjistratëve kosovarë si burim dyshimi në profesionalizmin dhe kualifikimin e këtyre magjistratëve për të shërbyer cilësisht në sistemin gjyqësor vendor. Një perceptim i tillë shkonte deri aty sa t’u vishte gjyqtarëve ndërkombëtarë në Kosovë një tnis arrogance që motivohej shpesh me trajtimin material të tyre të pakrahasueshëm me atë të kolegëve vendorë dhe me imunitetin diplomatik që gëzonin zyrtarët gjyqësorë ndërkombëtarë si nëpunës të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Megjithëse ngritja e kapaciteteve në gjyqësorin e Kosovës është parë gjithmonë si prioritet prej UNMIK-ut në kuadrin institucional pothuajse nuk ka pasur përpjekje në këtë drejtim. Ngritja kualitative e performancës dhe përmirësimi cilësor profesional i prokurorisë dhe gjyqësorit të Kosovës është artikuluar shpesh si nevojë në rrethin e përfaqësuesve ndërkombëtarë në këto institucione, por ky artikulum nuk është shoqëruar me veprime konkrete. Nëse në vitet e para të ndërfutjes në sistem të profesionistëve ndërkombëtarë, këta të fundit organizonin dhe merrnin pjesë në trajnime të përbashkëta profesionale me kolegët e tyre vendorë¹⁸, një praktikë e tillë erdhi duke u harruar për t’u braktisur me kohë plotësisht. Madje, as miratimin i legjislacionit të ri penal¹⁹ nuk u pa si

¹⁷ “Lessons from the Deployment of International Judges and Prosecutors in Kosovo” prej International Center for Transitional Justice, March 2006, fq. 15-17.

¹⁸ “Review of the Criminal Justice System in Kosovo”, OSCE/legal System Monitoring Section 2001.

¹⁹ Në 6 prill 2004 në fuqi hyri Kodi i Ri i Përkohshëm i Procedurës Penale dhe Kodi i Ri i Përkohshëm Penal i Kosovës. Këto dy ligje të rëndësishme u shpallën nëpërmjet Rregulloreve të UNMIK-ut Nr. 2003/26

një rast i mirë për të përfituar në këtë drejtim, duke organizuar seminare apo trajnime të përbashkëta mes gjyqtarëve/prokurorëve ndërkombëtarë dhe atyre vendorë për ballafaqimin e paqartësive, njehsimin e të kuptuarit të institucioneve të reja dhe ravijëzimin e praktikave të njehsuara në zbatimin e këtij legjislacioni. Seminare të veçanta u organizuan prej ekspertëve me profesionistët vendorë dhe të tjera me ata ndërkombëtarë a thua se flitej për çështje dhe akte krejt të ndryshme.

Një ndihmesë të lavdërueshme në drejtim të kualifikimit profesional të kuadrove të përfshirë në sistemin gjyqësor të Kosovës ka dhënë OSBE-ja dhe një numër i vogël OJQ-sh ndërkombëtare me veprim në fushën juridike në Kosovë si p.sh. ABA/CEELI.

Qendra Kosovare e së Drejtës është një organizëm i krijuar dhe mbështetur prej OSBE-së që kontribuon në drejtim të formimit profesional dhe trajnimit të vazhdueshëm të kuadrove në fushën e drejtësisë.

Ndihmesa e dhënë prej OSBE-së që në krijim si dhe mbështetja financiare dhe ajo teknike që ajo i ka ofruar Institutit Gjyqësor të Kosovës ka qenë fundamentale për ekzistencën e tij. Ngritja e Institutit ishte natyrisht një hap mjaft i rëndësishëm dhe projekt tejet ambicioz në fushën e profesionalizmit gjyqësor të Kosovës. Megjithëse projekti për arsye kryesisht financiare nuk ka arritur ende të finalizohet me transformimin e Institutit në shkollë magjistrature për përgatitjen ekskluzivisht të kandidatëve për të punuar në gjyqësinë e Kosovës, duhet thënë se ky institut ka dhënë një kontribut të paçmueshëm për trajnimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve kosovarë kryesisht me zbatimin e instrumenteve ndërkombëtarë në fushën e të drejtave të njeriut, njohjen e jurisprudencës së institucioneve ndërkombëtare në këtë fushë, por edhe në aspekte të tjera të së drejtës ndërkombëtare dhe asaj të zbatueshme. Instituti ka kryer funksionin e tij në mbështetje direkte të punës së institucionit të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial²⁰ që zëvendësoi në vitin 2001 Komisionin Këshillëdhënës Teknik për Çështje Gjyqësore dhe të Prokurorisë dhe Komisionin Këshillëdhënës Gjyqësor. KGJPK ishte një tjetër organizëm miks me përbërje ekspertësh vendorë dhe ndërkombëtarë që i propozonte PSSP-së emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë si dhe

dhe 2003/27 që në qershor 2003 për t'u lënë kohë gjyqtarëve dhe prokurorëve të familjarizoheshin me përmbajtjen dhe risitë e këtij legjislacioni.

²⁰ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/8 "Për krijimin e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës", prill 2001.

vendoste promovimin apo masa disiplinore ndaj këtyre të fundit. Këshilli i transformuar në vitin 2005 në Këshillin gjyqësor të Kosovës²¹, në bashkëpunim me Institutin Gjyqësor, ka ndihmuar në drejtim të përmirësimit të cilësisë në institucionet gjyqësore prej momentit të funksionimit të tij. Megjithatë, nevojë permanente, duke pasur në konsideratë ngarkesën e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve aktualë, mbetet rekrutimi i mëtejshëm i një numri profesionistësh të kualifikuar. Këshilli ka funksionuar si një organ i pavarur dhe puna e tij ka demonstruar që bashkëpunimi ndërmjet profesionistëve vendorë dhe ndërkombëtarë në fushën gjyqësore mund të funksionojë. Një tjetër organizëm ku një bashkëpunim i tillë ka dhënë frytet e veta është Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që Lidhem me Agjencinë Kosovare për Mirëbesim²². Dhoma ka pesë gjyqtarë në përbërje me shumicën (3 prej tyre) ndërkombëtare. Krijimi i “dhomës” përbën zgjerim të fushëveprimit të përfaqësimit ndërkombëtar në gjyqësorin Kosovar edhe në fushën civile, përkatësisht atë pronësore, për vetë problematikën e konflikteve dhe komplikimeve ndëretnike pronësore, të lidhura domosdoshmërisht me procesin e nisur me vonesë të privatizimit në Kosovën e pasluftës. Efiçienca e punës së kësaj gjykate të posaçme është tregues edhe i bashkëpunimit shembullor të gjyqtarëve ndërkombëtarë me ata vendorë.

Rritja e cilësisë profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve vendorë, tek sheh preokupacionin e vazhdueshëm të shprehur në çdo rast prej opinionit të kualifikuar ndërkombëtar në këtë fushë, natyrisht që në analizë të parë do duhej të kërkonte më tepër angazhim për mbështetje dhe bashkëpunim prej ndërkombëtarëve që operojnë në sistem. Por është më se e vërtetë se legjislacioni që ka bërë të mundur kooptimin e magistratëve ndërkombëtarë në sistem, si e analizuam më sipër, nuk ka lejuar një bashkëpunim më tepër se sipërfaqësor për të mundësuar njohjen dhe trajtimin e problemeve nëpërmjet bashkëpunimit. Rritja e cilësisë profesionale të gjyqtarëve vendorë nuk është parë prej prokurorëve dhe gjyqtarëve ndërkombëtarë si pjesë e punës së tyre, por thjesht si një arsye më tepër për të motivuar praninë e tyre në sistem. Puna e gjyqtarëve ndërkombëtarë fillon dhe mbaron me gjykimin e rasteve që u vihen përpara dhe shqetësim në këtë

²¹ Rregullorja e UNMIK-ut 2005/52 “Për krijimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës”.

²² Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13 “Për Krijimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit”.

kuadër, është dhe mbetet përmirësimi i mundësive të tyre për gjykimin e këtyre rasteve pa u preokupuar thellë për nevojat e sistemit në të cilin ata veprojnë përkohësisht. Në këtë linjë në vitin 2005 prokurorët dhe gjyqtarët ndërkombëtarë penalë, që deri atëherë ishin të stacionuar nëpër gjykatat e qarkut në mbarë Kosovën, u përqendruan në Prishtinë në një trend që çonte drejt centralizimit të procesit të veprimtarisë së tyre. Kjo lëvizje u motivuar me idenë se një kontribut më i rëndësishëm mund të ofrohej prej përqendrimit në një ambient të përbashkët pune. Natyrisht, kjo mund të ishte e vërtetë përse i përket efijencës së gjyqësorit të përfaqësuar prej ndërkombëtarëve, por në pikëpamje të bashkëpunimit me kolegët vendorë formalizonte moskomunikimin. Ky hap nuk mund të interpretohet në asnjë mënyrë si veprim i qëllimshëm në drejtim të vetizolimit të gjyqësisë ndërkombëtare, apo ndarjes prej sistemit ekzistues gjyqësor. Ky vendim u bazua vetëm në konsiderata ndaj nevojës për rritje të efijencës së punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë.

Nga ana tjetër, nevoja për rritjen profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve vendorë vihej përballë kërkesave të reja që sollin në vëmendje sofistikimi i krimit të organizuar dhe korrupsioni që bëhej shqetësues përballë mangësive të vërejtura në hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre formave të krimit në sistemin aktual. Një hap mjaft i dobishëm në drejtim të vënies në funksionim, për herë të parë me mjete legjislativë, të bashkëpunimit dukshëm të munguar mes vendorëve dhe ndërkombëtarëve në fushën e drejtësisë ishte krijimi i Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës. Projekti për vënien në funksionim të kësaj zyre u sendërtua vetëm pasi financimi u arrit më në fund të sigurohej prej Agjencisë Evropiane për Rindërtim. Zyra është në varësi organike të Zyrës së Prokurorisë Publike (KSPO) të Kosovës dhe mandati parashikon ushtrimin e ndjekjes penale të rasteve penale “të profilit të lartë”. Pjesë e organikës së kësaj zyre është një numër prokurorësh ndërkombëtarë që kanë për detyrë, veç të tjerash, të trajtojnë kolegët e tyre vendorë gjatë punës së tyre të përditshme. Rezultatet e bashkëpunimit në nivel të KSPO-së mbeten për t’u vlerësuar në kohë, por ama duhet theksuar se ky institucion përbën provën se tashmë bashkëpunimit mes vendorëve dhe ndërkombëtarëve në sistemin gjyqësor ka hyrë në një fazë të re.

5. Impakti i Statusit Politik mbi Performancën Gjyqësore dhe Perspektiva e Ekzistencës së Sistemit Miks.

Kuadri politik në të cilin është zhvilluar deri në stadin e tanishëm gjyqësori Kosovar është tepër unik dhe proceset politike që kanë ndodhur dhe ndodhin me një dinamikë të jashtëzakonshme natyrisht që lenë gjurmët e tyre në sistemin gjyqësor. Një prej të metave të mëdha, që vjen si peshqesh i organizimit politik të vendit dhe që e ka shoqëruar që në lindje sistemin gjyqësor të pasluftës, është natyrisht përkohshmëria e mandatit të gjyqtarit. Për përkohshmëri të mandatit nuk mund të flitet vetëm në rastin e gjyqtarëve ndërkombëtarë, ku rëndom mandati zgjat vetëm gjashtë muaj, por sidomos për sa u takon gjyqtarëve vendorë, mandati i të cilëve është i limituar në kohë në varësi të mandatit të përkohshëm të administrimit të përkohshëm ndërkombëtar në Kosovë. Pakufizueshmëria e mandatit të gjyqtarit, si kërkesë fundamentale e shtetit të së drejtës, nuk mund të gjejë zbatim në Kosovë në planin formal pa u përcaktuar statusi final i Kosovës.

E ndërsa procesi i përcaktimit të statusit ka hyrë tanimë në fazën e tij finale, bashkëjetesa mes magistratëve vendorë e ndërkombëtarë duket se do të vazhdojë të ekzistojë edhe për një periudhë kohe ende të papërcaktuar. Në raportet e vazhdueshme mbi situatën e gjyqësorit në Kosovë si pjesë e organizimit të përgjithshëm politiko juridik të Kosovës së pasluftës, përfaqësuesit eminentë, politikë ose jo, theksojnë nevojën e pranisë së ndërkombëtarëve në sistem. Kështu në raportin e tij mbi situatën në Kosovë të datës 7 tetor 2005, i Dërguari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Kai Aide në konkluzionet mbi gjyqësorin thekson “Sistemi gjyqësor i Kosovës shihet gjërësisht si institucioni më i dobët i Kosovës...Vazhdimi i prezencës së gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë do të nevojitet për të trajtuar rastet e krimit të organizuar, korrupsionit si dhe rastet e ndërlikuara ndëretnike. Reduktimi në proces i numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë është i parakohshëm dhe duhet rishqyrtuar me urgjencë. Ky reduktim do të rezultojë në humbje të besueshmërisë të sistemit gjyqësor dhe besimit tek ky sistem të popullatës në përgjithësi dhe sidomos komuniteteve minoritetet. Ka pak arsye

për të besuar se gjyqtarët dhe prokurorët vendorë do të jenë në gjendje të përmbushin në një të ardhme të afërt funksionet që aktualisht ushtrohen prej personelit ndërkombëtar²³.

Në këtë optikë, presidenti Ahtisaari në propozimin e tij për statusin e ardhshëm të Kosovës, në aneksin mbi prezencën civile ndërkombëtare në Kosovë, sugjeron në mënyrë të qartë dhe shumë eksplicite që misionin i ri ndërkombëtar në Kosovë në fushën e shtetit të së drejtës (apo zbatimit të ligjit) do të ketë kompetenca të sigurojë hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin në mënyrë të duhur të krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve ndëretnike, krimeve financiare/ekonomike dhe krimeve të tjera të rënda kur është e nevojshme prej hetuesve prokurorëve apo gjyqtarëve ndërkombëtarë që ushtrojnë aktivitet në Kosovë, në bashkëpunim me autoritetet kosovare (në rastet e gjyqtarëve në kolegje mikse me kolegë vendorë) apo në mënyrë të pavarur²⁴. Si të shtrinte trasenë e rrugës së përbashkët që mbetet për t'u përshkuar prej të dyja palëve në arritjen e qëllimit të përbashkët në këtë fushë, propozimi madje u ngarkon autoriteteve vendore në fushën e së drejtës detyrën e bashkëpunimit me misionin e ri ndërkombëtar për lehtësimin e detyrave të marra përsipër prej tij në këtë fushë nëpërmjet lejimit të qasjes së plotë dhe të menjëhershme në çdo vend, person, aktivitet, dokument apo procedurë në Kosovë.²⁵ Jo më pak të detajuara në Propozim paraqiten dhe sugjerimet lidhur me përbërjen mikse (2 ndërkombëtarë + 1 gjyqtar vendor) të kolegjeve të reja për t'u krijuar në Dhomë e Veçantë të Gjykatës Supreme²⁶ për të shqyrtuar në shkallë të dytë probleme të veçanta lidhur me procesin e privatizimit, përveç kolegjit të të pestëve që është aktualisht në funksionim dhe që propozohet të shndërrohet në shkallën e tretë të shqyrtimit gjyqësor të pretendimeve pronësore të rrjedhura prej procesit të privatizimit. Praninë ndërkombëtare në Gjykatën Supreme Propozimi e shtrin dhe në trajtimin e ankesave të lidhura me aktivitetin e Agjencisë Pronësore të Kosovës. Kolegji i veçantë që propozohet të ngrihet për këtë qëllim ka në përbërje 2 gjyqtarë ndërkombëtarë dhe një vendor.²⁷

²³ "A comprehensive review of the situation in Kosovo" nga Kai Aide, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, para. 35, 40.

²⁴ Report of the Special Envoy of the Secretary General on Kosovo's Future Status – Comprehensive Proposal for Future Status Settlement/ Annex IX, 2.3/ a, b, c, f. 54.

²⁵ Po aty, 2.3/g,

²⁶ Po aty, Annex VII, Neni 3.

²⁷ Po aty, Neni 5.

Megjithë pasigurinë mbi zbatimin apo jo të planit të Ahtisaarit, që së fundi ka nisur të artikulohet megjithëse dobët në arenën politike ndërkombëtare të angazhuar në finalizimin e procesit të përcaktimit të statusit, duhet thënë që Bashkimi Evropian nëpërmjet Ekipit të Planifikimit të misionit të tij të ardhshëm në Kosovë nuk hezitoi të materializojë në organogramin e stafit të misionit të tij të ardhshëm propozimin e presidentit Ahtisaari. Në kuptim të ruajtjes së përbërjes mikse të sistemit gjyqësor planifikohet që prania ndërkombëtare të jetë më e zgjeruar dhe bashkëpunimi të ngrihet në një nivel tjetër. Kështu numri i përgjithshëm parashikuar i gjyqtarëve ndërkombëtarë në sistem është 43 me një ndarje 3 gjyqtarë penalë ndërkombëtarë në Gjykatën Supreme, 3 gjyqtarë ndërkombëtarë në Dhomën e Veçantë për Çështje të Lidhura me AKM-në, 17 gjyqtarë penalë ndërkombëtarë në nivel të gjykatave të qarkut, 10 gjyqtarë ndërkombëtarë për të shqyrtuar në shkallë të parë çështje të lidhura me AKM-në dhe 10 gjyqtarë civilë ndërkombëtarë në nivel gjykate qarku. Numri i prokurorëve ndërkombëtarë është parashikuar të jetë 17.²⁸

Pa hyrë në analiza nëse është e ekzagjeruar apo jo prania ndërkombëtare në sistemin gjyqësor Kosovar, sipas ekipit planifikues të misionit të ardhshëm ndërkombëtar të BE-së në Kosovë, ajo që vlen të theksohet është qasja që misioni i ardhshëm ndërkombëtar pritet të ketë ndaj bashkëpunimit në fushën gjyqësore. Gjyqtarët ndërkombëtarë do të jenë të stacionuar nëpër gjykatat e qarkut dhe jo vetëm në Prishtinë. Roli i tyre do të jetë jo vetëm gjykimi i çështjeve penale të kategorizuara si të gjykueshme prej tyre, por gjithashtu dhe për më tepër, ata duhet të angazhohen në monitorimin dhe ndjekjen e ecurisë së punës së gjykatave ku janë të alokuar për të ndihmuar rritjen e performancës së tyre.

6. Konkluzione

Tashmë është e qartë se ekzistojnë dy sisteme paralele pothuajse të pavarur brenda gjyqësorit kosovar, në fushën penale: sistemi gjyqësor penal ndërkombëtar – mund të cilësohet fare mire dhe kështu aktiviteti i gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë dhe sistemi kosovar i drejtësisë penale i menaxhuar prej institucioneve gjyqësore vendore. Megjithëse nuk njihet formalisht ekzistenca paralele e këtyre dy sistemeve, mungesa e

²⁸ Package Job Descriptions Future ESDP mission, në: www.eupt-kosovo.eu.

bashkëpunimit ndërmjet aktorëve vendorë ndërkombëtarë ka mundësuar një zhvillim të pavarur të dy komponentëve përkatës Brenda gjyqësorit kosovar, të cilët tanimë operojnë përkrah njëri-tjetrit. Nga ana tjetër, sistemi gjyqësor në tërësi vazhdon të mbetet i dobët dhe problematik dhe nevoja për reformimin e tij mbështetet gjerësisht.

Megjithë përvojën jo shembullore të deritanishme të bashkëpunimit midis profesionistëve vendorë e ndërkombëtarë në fushën gjyqësore dhe për më tepër megjithë paragjykimet reciproke të palëve, është e qartë se edhe në një të ardhme të afërt gjyqtarët dhe prokurorët kosovarë do të duhet të ndajnë me kolegët e tyre ndërkombëtarë suksesin apo dështimin e konsolidimit të sistemit gjyqësor në Kosovë. Problemet e panumërta që bashkëpunimi i ndërsjellë dhe i sinqertë ka hasur në këto vite të mundimshme të rivënies në funksionim të këtij sistemi mund të përbëjnë një bazë të mirë për të kuptuar se çka duhet evituar për të nisur me këmbën e mbarë një bashkëpunim të ri në kushtet e Kosovës post-UNMIK.

Nëse ky bashkëpunim do të shihej nga një prizëm pozitiv, Kosova ka një shans të artë që të shfrytëzojë në mënyrë të drejtpërdrejtë asistencën teknike të Bashkimit Europian për të luftuar në sistemin e saj gjyqësor dukuri dhe problematika me të cilat vendet e rajonit kanë vite që rreken ti luftojnë dhe jo gjithmonë me sukses. Perspektiva e njejtë evropiane imponon arritjen e standardeve të larta në dhënien e drejtësisë dhe Kosova ka mundësinë që këto standarde t'i ketë të demonstruara në sistem prej gjyqtarësh dhe prokurorësh që i zbatojnë ato sot e çdo ditë në vendet e tyre.

Natyrisht, bashkëpunimi është një sfidë më vete, e nëse palët i qasen në mënyrën dhe me vullnetin e duhur për të arritur objektiva që nuk kanë arsye pse të mos jenë të përbashkëta, bashkëpunimi natyrisht do të rezultojë pozitivisht.

BIBLIOGRAFI

Artikuj dhe raporte:

T. Perriello and M. Wierda, *Lessons from the Deployment of International Judges and Prosecutors in Kosovo*, International Center for Transitional Justice, March 2006, fq. 11 (shih online: <http://www.ictj.org/static/Prosecutions/Kosovo.study.pdf>).

Judicial Reform Index for Kosovo – ABA/CEELI, prill 2002, fq. 8 (online në: <http://www.abanet.org/rol/publications/kosovo-jri-2002-eng.pdf>).

“Review of the Criminal Justice System in Kosovo”, OSCE/legal System Monitoring Section 2001.

“Preparing for transfer of justice sector policy making in Kosovo” – Atos KPMG Consulting November 2003.

Report of the Special Envoy of the Secretary General on Kosovo’s Future Status – Comprehensive Proposal for Future Status Settlement.

Legjislacion:

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/5 “Për krijimin e Gjykatës *ad hoc* të instancës së fundit dhe prokurorisë *ad hoc*”, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut.

Rregullorja e UNMIK –ut 1999/6 “Për rekomandimet mbi strukturën dhe administratën e shërbimit gjyqësor dhe të prokurorisë”, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut.

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/7 “Për Emërimin dhe Shkarkimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut.

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/6 “Për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të prokurorëve ndërkombëtarë dhe gjyqtarëve ndërkombëtarë”, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut.

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/34 “Mbi ndryshimin e Rrregullores së UNMIK-ut 2000/6 Për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të prokurorëve ndërkombëtarë dhe gjyqtarëve ndërkombëtarë”, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut.

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 “Për caktimin e gjyqtarëve /prokurorëve ndërkombëtarë dhe/ose ndryshimin e vendit të zhvillimit të gjykimit.”

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/8 “Për krijimin e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës”, prill 2001.

Rregullorja e UNMIK-ut 2005/52 “Për krijimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës”.

Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13 “Për Krijimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme për Çështje që lidhen me Agjensinë Kosovare të Mirëbesimit”.